



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Predata Received/Delivery	06.12.2021	1	viti year
Organ /Bjësia Organ./Jednica Org./Unit	Hi Prot Bj Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Kopje Kopija Quantity
SKP/HV	5836/2021		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.878/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.878/2021 të datës 22.10.2021, të parashtruar nga ankuesit \_\_\_\_\_ përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ me adresë Sheshi "Nënë Tereza" Oda Ekonomike e Kosovës, Nr.20, Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministrit të Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.12.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.878/2021 e datës 22.10.2021 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.5/2021 i datës 01.10.2021 i Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.**

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ me datë 22.10.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokoli 5116/2021 të regjistruar me numër A.nr.878/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.5/2021 të datës 01.10.2021 të Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në



Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit për Emërimin e Zyrtareve Publikë, dhe Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Këshilli, me datë 05.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 5116/2021 të regjistruar me numër A.nr.878/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 12.10.2021; Konkursin e datës 11.07.2021; Vendimin e datës 09.08.2021 me numër të protokollit 18/2021; Aneksen e datës 09.08.2021 me numër 18/2021; Vendimin e datës 01.10.2021 me numër 5/2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.10.2021 me numër të protokollit 5198/2021; Përgjigjen në ankesë të datës 05.11.2021 me numër të protokollit 5318/2021; Ndryshimin e aktit të emërimit të datës 02.12.2012 me numër të protokollit 781; Listën e aplikimit sipas sistemit SIMBNJ; Njoftimin e datës 09.08.2021; Listën e aplikantëve sipas sistemit të SIMBNJ-se për kandidatet e aprovuar dhe kandidatet e refuzuar; Emalin e datës 10.08.2021; Ankesën e datës 27.09.2021 me numër të protokollit 1248; Emalin e datës 04.10.2021; Njoftimin e datës 18.10.2021; Vendimin e datës 15.10.2021 për vlerësimin përfundimtar të kandidateve; Aplikacionin e datës 18.07.2021 të ankuesit; Shtojcën e diplomës të datës 30.06.2015 të ankuesit; Diplomën e datës 12.07.2001 të ankuesit me të cilën merr titullin Inxhinier i diplomuar i Makinerisë; Raportin vjetor të vlerësimit për vitin 2020 në Agjencinë e Regjistrimit Civil; Raportin vjetor të vlerësimit të datës 31.01.2020 për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2019; Vërtetimin e datës 11.03.2021 me numër të protokollit 244/2021; Certifikatën e datës 08.03.2021 me numër 5010/2021 nga evidenca personale kundër të cilit nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo Gjykatë; Letrën e motivimit të datës 16.07.2021; Letrën reference të datës 01.03.2021; Letrën e referencës të datës 05.02.2021; Certifikatën e datës 11.06.2013; Certifikatën e datës 01.06.2005; Vendimin e datës 04.05.2017 me numër 14/14; Vendimin e datës 06.05.2020 me numër 614/2020; Vendimin e datës 21.11.2012; Certifikatën e datës 22.06.2021; Certifikatën e datës 11.06.2013; Certifikatën për vitin 2005; Certifikatën e datës 25-28 të vitit 2019; Certifikatën e datës 26-27.09.2016; Certifikatën e datës 15 janar deri 27 mars 2007; Certifikatën për periudhën kohore Prill 2014; Certifikatën e datës 22. 11.2016; Certifikatën e datës 24 prill deri 09 maj të vitit 2003; Certifikatën e datës 21.03.2006; Certifikatën e datës 05.03.2005; Certifikatën e datës 26.03.2004; Certifikatën e datës 14.07.2000; Vendimin e datës 24.05.2021 me numër të protokollit 0194/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

Sipas shkresave të lëndës është konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 11.07.2021 ka shpallur konkursin me numër reference RN00007102 për pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit, ka përcaktuar se pranimi është i mbyllur, duke specifikuar se: *Të drejtë aplikimi në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të kategorisë lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil.*

Ankuesi, për këtë pozitë të punës, me datë 18.07.2021 ka dorëzuar aplikacionin me numër reference RAN00000470, mirëpo Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në fazën e verifikimit të dokumentacionit, ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 18/2021 të datës 09.08.2021, përmes të cilit ka refuzuar aplikacionin e ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk ka sjellë dëshmi se është nëpunës civil ekzistues i kategorisë se mesme apo të lartë drejtuese ashtu siç është kërkuar në konkurs.

I pakënaqur me vendimin mbi refuzimin e aplikacionit, ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 27.09.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1248 në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 01.10.2021 ka nxjerr Vendimin Nr.5/2021 përmes të cilit ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 27.09.2021.

Kundër Vendimit Nr.5/2021 të datës 01.10.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të: Shkeljes së dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë; dhe Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankuesi në ankesën e parashtruar thekson se nga data 08.05.2000 deri me datë 24.05.2021 ka ushtruar pozita të ndryshme në MBP, dhe si rrjedhojë me datë 02.12.2013 ka marr Akt Emërimin me afat të pacaktuar si punëtor i Shërbimit Civil. Me tutje ankuesi thekson se nga viti 2017 deri në vitin 2021 ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe se deri me tani nuk ka pranuar asnjë vendim për shkëputje të marrëdhënies së punës, andaj i njëjti e konsideron vetëm pjesë të Shërbimit Civil, dhe si rrjedhojë vlerëson se padrejtësisht është eliminuar nga gara për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se është eliminuar padrejtësisht nga gara për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 40 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil,*

dhe si rrjedhoje ka konstatuar se pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese fillimisht është procedurë e cila zhvillohet brenda Shërbimit Civil dhe të drejtë aplikimi kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese, siç përcaktohet me nenin 33 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në kuadër të shkresave të lëndës ka gjetur si provë Ndryshimin e Aktit të Emërimit me numër protokollit 781 të datës 02.12.2013 përmes të ankuesi është emëruar Drejtor i Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve në Agjencinë e Regjistrimit Civil, pozitë kjo e kategorisë së mesme drejtuese, si dhe Vendimin Nr.14/144 të datës 04.05.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit i njëjti është emëruar në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, gjegjësisht Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për periudhën 04.05.2017 - 04.05.2020. Mirëpo, në kuadër të shkresave të lëndës, nuk është gjetur asnjë provë e cila dëshmon se ankuesi e ka pezulluar marrëdhënien e punës deri sa ka qenë duke ushtruar pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, andaj në mungesë të një akti administrativ të organit të punësimit i cili do t'i jepte të drejtë ankuesit për kthimin e tij në pozitën paraprake pas përfundimit të mandatit si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesi se i njëjti e ka statusin e nëpunësit civil, dhe mban pozitë të kategorisë së mesme drejtuese, me çka do të plotësonte kushtin ligjor për aplikim për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, është i pabazuar.

Kolegji, po ashtu në shkresa të lëndës ka gjetur Vendimin Nr.614/2020 të datës 06.05.2020 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes të cilit ankuesi është caktuar Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, mirëpo ky vendim ka për qëllim vetëm ushtrimin e përkohshëm të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, dhe si i tillë nuk i krijon bazë ligjore ankuesit që ta konsiderojë veten nëpunës civil të kategorisë së lartë apo të mesme drejtuese në kuptim të plotësimit të kushteve siç parashihet me nenin 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit mbi këtë bazë ligjore janë të pa bazuara.

Andaj, duke marrë parasysh se ankuesi me rastin e aplikimit nuk ka sjellë asnjë dëshmi me shkrim se i njëjti në kohën e aplikimit ka qenë i emëruar dhe duke ushtruar pozitë të kategorisë së lartë apo të mesme drejtuese, Kolegji vlerëson se Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të DMZP-së, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 18/2021 të datës 09.08.2021, përmes të cilit ka refuzuar aplikacionin e ankuesit për shkak të mos përmbushjes së kushteve ligjore, dhe Vendimit Nr.5/2021 të datës 01.10.2021 për refuzimin e ankesës si të pa bazuar, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 8 paragrafi 5 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve Civil të Nivelit të Lartë Drejtues, ndërlidhur me nenin 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.878/2021

**Avdyl Bekteshi**

*Avdyl Bekteshi*  
**Procesmbajtës**



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;